



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi – Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni vjeshtor**

**Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal**  
Mbledhja nr.51/2018  
Prishtinë, më 10.12.2018, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Liburn Aliu, Hykmete Bajrami, Lutfi Zharku, Muharrem Nitaj, Veton Berisha dhe Duda Balje, anëtarë.

**Munguan:** Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Glauk Konjufca, dhe Memli Krasniqi, anëtarë.

**Pjesëmarrës i ftuar:** Bekim Jupa, zëvendësministër i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

**Pjesëmarrës tjerë:** Durim Limaj, Anita Sutaj dhe Rexhep Bllaca–MTI, Agim Maraj–Ambasada e Britanisë së Madhe, Liridon Gashi – SEEF, Donika Bekteshi – KDI, Dortina Kastrati–BIRN, Vatra Qehaja – LVV, Dren Ajeti- Klubi i Prodhuesve, Festina Veselaj-Handikos, Sanije Jusufi –Koha Ditore dhe Drita Vitia – Radio Kosova.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti, Veton Raci dhe Nurije Morina.

**Mbledhjen e kryesoi:** Sala Berisha Shala, kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

- 1.Miratimi i rendit të ditës;**
- 2.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 26.11.2018;**
- 3.Shqyrtimi i Projektligjit Nr.06/L-138 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Protokollin Shtesë të Marrëveshjes për Amendimin dhe Aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore;**
- 4.Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;**
- 5.Të ndryshme.**

*Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

## **1.Miratimi i rendit të ditës**

**Hykmete Bajrami**, kërkoi që të hiqet nga rendi i ditës, për këtë mbledhje, pika e 4 (katër) dhe ti kthehet Qeverisë. Këtë po bëjmë duke iu referuar letrës që na ka dërguar kompania e angazhuar nga Ambasada e Britanisë së Madhe, që ka nënshkruar memorandumun e bashkëpunimit me Qeverinë dhe Kuvendin, në lidhje me përzgjedhjen e anëtarëve të bordeve të agjencive të pavarura. Siç thuhet në e-mail, Qeveria as që është konsultuar më këtë kompani, prandaj për këtë duhet të kërkohet sqarim nga Qeveria, përndryshe e lëshojmë mbledhjen.

**Muharrem Nitaj**, tha meqë sa e dimë, ky bordi i AKP-së nuk është pjese e memorandumit për monitorim, megjithatë nëse duhet të kërkohet sqarim nga Qeveria, këtë duhet ta bëjmë. Në rastin konkret, nuk kemi bëjmë më konkurs por më emërim, ashtu siç e thotë ligji, prandaj roli i monitorimit nuk vlen. Kërkesa duhet më qenë e qartë për Qeverinë, se a është në listën e Qeverisë monitorimi për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

**Liburn Aliu**, tha se pajtohet që ky propozim vendimi i Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ti kthehet Qeverisë, pasi që përzgjedhja e këtyre anëtarëve nuk është monitoruar nga kompania, e cila është caktuar nga Ambasada e Britanisë së Madhe dhe është shqetësuese, pse nuk iu lejohet ky monitorim.

**Kryetarja**, theksoi se në fakt, nuk e kemi listën së për cilat borde të agjencive të pavarura është nënshkruar memorandumun i bashkëpunimit për monitorim dhe pajtohem që të kërkohet kjo listë nga Qeveria. Por, në bazë të Ligjit nr.03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të ndryshuar më Ligjin nr.04/-034; nr.05/-080 dhe nr.06/-023, në nenin 8, që ndryshon Ligjin bazik neni 12, citoj: “2. Kuvendi i Kosovës me propozim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, emëron drejtorët e Bordit, duke përfshirë një përfaqësues nga komunitet joshumicë si dhe një përfaqësues nga Konfederata Sindikale e punëtorëve. 3. Kuvendi i Kosovës me propozim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nga radhët e anëtarëve të Bordit cakton kryesuesin e Bordit”. Pra, siç mund të vëreni, në asnjë dispozitë ligjore nuk obligohet, as Qeveria e as Kuvendi, që të zhvillojë një konkurs apo një formë tjetër, si p.sh të ofrojë dy kandidatë për një pozitë. Madje, ky ligj është miratuar në po këtë legjislaturë, pra me 30.3.2018. Çka do të thotë në bazë të ligjit jemi në rregull, por pajtohem që të kërkohen sqarime.

**Hykmete Bajrami**, theksoi se zgjedhja e bordit të AKP-së është në listën e marrëveshjes dhe përsëriti që të kërkohet sqarim nga Qeveria pse s’është përfshirë kjo kompani në këtë proces.

**Dardan Sejdiu**, tha se pajtohem që të kërkohen sqarime, pasi që është problem trajtimi i kësaj teme, pa pasur informacion e plotë.

*Rendi i ditës u miratua me ndryshimin e propozuar nga deputetja Hykmete Bajrami.*

*Komisioni vendosi që t’i dërgojë shkresë Qeverisë/Kryeministrit, që të jap sqarimet e nevojshme se pse projekti i Ambasadës së Britanisë së Madhe për përzgjedhjen e zyrtarëve të lartë, nuk është përfshirë në këtë proces.*

## **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 26.11.2018;**

*Procesverbali i datës 26.11.2018, u miratua pa vërejtje.*

## **3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.06/L-138 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Protokollin Shtesë të Marrëveshjes për Amendimin dhe Aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore;**

**Kryetarja**, potencoi se për këtë pikë është ftuar ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, mirëpo, në mungesë të tij, do të paraqitet zv.ministri Bekim Jupa, të cilit ia dha fjalën, për ta paraqitur arsyetimin e Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për Protokollin Shtesë të Marrëveshjes për Amendimin dhe Aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore.

**Bekim Jupa, zëvendësministër i Ministres së Tregtisë dhe Industrisë**, e paraqiti ekspozenë e Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për Protokollin Shtesë të Marrëveshjes për Amendimin dhe Aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore. Ky projektligj është një ndër prioritetet e Qeverisë së Kosovës, sepse ky akt ligjor rregullohet, mbrohet dhe zbatohet në dobinë dhe të mirën e interesit publik, duke e pas parasysh sepse vendet anëtare të Marrëveshjes së CEFTA-s, në përputhje me objektivat politike të Procesit të Berlinit dhe në përgjigje të nevojës për thellimin e mëtejshëm të integritetit tregtar në rajon, kanë negociuar Protokollin Shtesë 5, i cili synon krijimin e sienergji në mes vendeve të rajonit për lehtësimin e tregtisë. Andaj, Qeveria e Republikës së Kosovës ka vendosur që ky akt ligjor të jetë një ndër ligjet me prioritet për tu hartuar dhe që është përfshirë në Programin Legjislativ të Qeverisë për vitin 2018, i miratuar në mbledhjen e 20-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me Vendimin Nr.0/20, datë 20.12.2017. Projektligji ka për qëllim të ratifikojë marrëveshjen e cila mbështetet në dispozitat kryesore të Marrëveshjes së Lehtësimit të Tregtisë në OBT dhe në disa raste parashikon edhe angazhime shtesë, vetëm për lehtësimin e tregtisë me vendet e rajonit. Kjo marrëveshje synon thjeshtësimin e inspektimeve, reduktimin e formaliteteve të importit dhe eksportit, shkëmbimin elektronik të të dhënave, njohjen reciproke të testeve laboratorike dhe programit të Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar, zbatimin efektiv të kontrollit të riskut. Ky protokoll i shtrin efektet e tij edhe tek të gjitha agjencitë e tjera që veprojnë në kufi dhe kjo është vlera e shtuar thelbësore e këtij protokollit, e cila është mbështetur në filozofinë e lehtësimit të tregtisë së miratuar nga të gjitha vendet anëtare të OBT-së, në Marrëveshjen e Lehtësimit të Tregtisë.

**Kryetarja**, theksoi se ne duhet ti bëjmë dy korrigjime teknike, të cilat duhet të paraqiten në formë amendamentesh në projektligj, pra si në vijim:

*Amendamenti 1 Neni 2, fjalia “është aprovu” zëvendësohet me “që është miratuar”.*

*Amendamenti 2 Neni 3, fshihet fjalia “për ratifikim e marrëveshjes”.*

**Dardan Sejdiu**, kërkoi sqarime se a është marrëveshja e CEFTA-s në pikëpyetje tani lidhur më këtë marrëveshje? Ky protokoll shtesë si ndërlidhet më marrëveshjen më Serbinë, për lëvizjen e lirë të mallrave, në raport më Marrëveshjen e Brukselit? Në nenin 2.1, është fjalia e fundit, shkëmbimin e të dhënave, në lidhje me transportin e mallrave ndërmjet palëve të CEFTA-s dhe bashkëpunimin e programeve për partneritet tregtar, si e realizon shkëmbimin e

të dhënave në raport me Serbinë dhe me Marrëveshjen e Brukselit? Në nenin 4, krijimi i kontrollit kufitar “one stop” (me një ndalesë), si trajtohet kjo më Serbinë? Te Neni 8, Formalitetet që lidhen me importimin, eksportimin dhe transitin, a ka dualizëm me Serbinë, apo e njëjta vlen për të gjitha palët tjera? Për regjistrimin automjeteve, a vlen Marrëveshja e Brukselit dhe këto a hiqen tabelat e automjetit? A duhet edhe këtu të ndërtohet një lloj dualizmi me Serbinë, si dhe a ka ndonjë koherencë në vendimmarrje?

**Durim Limaj, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë,** sqaroi se nuk ka problem substancial në raport me Marrëveshjen e CEFTA-s, kur është nënshkruar kjo marrëveshje. Kosova ka qenë palë e barabartë më të gjitha shtetet nënshkruese. Por, në raport me Serbinë, jemi duke i shikuar dha analizuar të gjitha çështjet tregtare se si do të veprojmë.

**Dardan Sejdiu,** pyeti se a vlen edhe me Serbinë ky protokoll, që po ratifikohet?

**Durim Limaj,** theksoi se po.

**Rexhep Bllaca, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë,** sqaroi se protokollin duhet të zbatohet për të gjitha shtetet anëtare të CEFTA-s, ndërsa, nëse nuk zbatohet nga ndonjë shtet, atëherë është nenin 29 i kësaj marrëveshjeje, që ndërmerren masat e njëjta.

**Dardan Sejdiu,** pyeti se sa herë është marrë ndonjë veprim në aspektin regjional?

**Durim Limaj,** tha që në vitin e fundit, janë marrë masa për disa produkte, si për miell, bollka dhe pemë e perime.

**Rexhep Bllaca, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë,** theksoi se masat janë marrë në bazë të ligjeve në fuqi, siç janë: Ligjet për masat mbrojtëse në importe dhe masat antidamping.

**Hykmete Bajrami,** kërkoi sqarim, se a është bërë Ratifikimi i kësaj Marrëveshjeje edhe në shtetet tjera?

**Durim Limaj, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë,** tha që në bazë të informatave që kemi, këtë marrëveshjeje e kanë aprovuar të gjitha parlamentet e shteteve aderuese në këtë marrëveshjeje.

**Liburn Aliu,** pyeti se cili është ndikimi i kësaj marrëveshjeje në taksën e vënë 100 për qind, ndaj Serbisë?

**Durim Limaj,** tha që taksa është ndërmarr vetëm ndaj një shteti, duke i zbatuar masat e reciproke dhe nuk ka ndikim kjo marrëveshjeje në taksën e vendosur nga shteti jonë në 100 %, ndaj produkteve të Serbisë.

*Pas debatit Komisioni më 6 (gjashtë) vota për dhe 1 (një) kundër, nxori këtë:*

*Përfundim*

*Kuvendi të miratojë Projektligjin Nr.06/L-138 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Protokollin Shtesë 5, të Marrëveshjes për Amendimin dhe Aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore, me amendamentet si në vijim:*

*Amendamenti 1 Neni 2, fjalia “është aprovu” zëvendësohet me “që është miratuar”*

*Amendamenti 2 Neni 3, fshihet fjalia “për ratifikimin e marrëveshjes”.*

#### **4. Të ndryshme.**

##### **Çështjet vijuese**

**Dardan Sejdiu**, tha se edhe pse s’është pjesë e fushëveprimit të Komisionit, por që do të duhej të ishte, propozoi që në mbledhjen e radhës të ftohet Besim Beqaj, ministër i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, në lidhje me punën e ministrisë për këtë vit, me theks të veçantë, ndarja e fondeve dhe grandëve për “start up” dhe bizneset tjera, si dhe planifikimi i punëve për vitin e ardhshëm.

**Hykmete Bajrami**, e përkrahu propozimin dhe potencoi se ka qenë edhe propozim i saj, madje është përfshirë në planin e punës së Komisionit, dhe propozimi u përkrah nga *Komisioni*.

**Kryetarja**, propozoi që ditët në vijim të vizitohen ndërmarrjet publike dhe bizneset dhe kërkoi që deputetët ti përgjigjen thirrjes për vizita në terren, sepse në shumicën e rasteve ata po mungojnë, propozim ky që u përkrah nga *Komisioni*.

**Mbledhja përfundoi në orën 12:15.**

**E përgatiti: Staf i mbështetës i Komisionit.**

**Kryetarja e Komisionit,**

**Sala BERISHA SHALA**